

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje pjesë këmbimi për infrastrukturën e sistemit të transmetimit DataCom”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(FPP) Pajisje të transmetimit të të dhënave 32260000-3, Pjesë këmbimi dhe pajisje radar 32352200-7.

VLERA E FONDIT LIMIT I KONTRATËS: 9,995,500 (nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e pesëqind) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara në rolin e Organit Qëndror Blerës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, ndërsa nga ana e grupit të punës të ngritur pranë Autoritetit Kontraktor përfitues Departamenti për Teknologjinë e Informacionit/Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit janë hartuar specifikimet teknike me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”. Në nenin 55 pika 4 të VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës "Procedurë e hapur të thjeshtuar" edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më të vogël se 20% e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose/dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar nenit 55, pika 4(b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55 pika 4 gërma (b) e VKM nr 285 dt 19.05.2021 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar) duke qënë se vlera e fondit limit është nën kufirin e ulët monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të dorëzojë Autorizim/Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar nga prodhuesi për artikujt/zërat objekt prokurimi 1, 2, 7, 11, 12. Operatori ekonomik ofertues në rast paraqitje autorizimi nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të provojë lidhjen ndërmjet prodhuesit dhe distributorit zyrtar të autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: (telefon, fax, e-mail, website) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave.

Kriteri është hartuar në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e

rregullave të prokurimit publik”. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Në këtë kontekst, është domosdoshmërisht në dobi të përfituesve finale dhe produkteve/shërbimeve më cilësore, pra garanci për zbatimin me rigorozitet të furnizimit të mallit. Në këtë mënyrë provohet dhe aftësia reale e operatorit ekonomik për të realizuar kontratën në cilësi, sasi e kohë. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

Kërkimi i autorizimit nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për këto pajisje është një masë e mirë për të mbrojtur interesat e institucionit dhe për të siguruar një prokurim të drejtë dhe transparent. Kërkesa për autorizim nga prodhuesi ose distributori zyrtar lidhur me keto pajisje sipas përcaktimit të bërë në pikën 2.3.2 është bere për faktin se duhet të ketë nje përputhshmëri të garantuar të këtyre pajisjeve me sistemin ekzistues dataCOM. Pajisjet janë pjesë e një infrastrukture të integruar dhe kërkojnë komponentë origjinalë për të siguruar funksionim të saktë dhe pa ndërprerje. Zëvendësimi me pjesë jo të autorizuar mund të shkaktojë mosfunksionim, humbje të garancisë, ose probleme të ndërlikuara teknike. Sistemi Datacom përdoret për komunikim të sigurisë publike, ku çdo defekt mund të ndikojë në operacione të ndjeshme.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog /skede teknike të lëshuar/publikuar nga prodhuesi, për artikujt/zërat objekt prokurimi 1, 2,7, 11, 12 duke shënuar/markuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secilin nga artikujt e ofruar sipas modelit të deklaruar dhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST. (Katalogu/skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të cdo artikulli që është objekt i prokurimit me qëllim që Autoriteti Kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të modelit të ofertuar do të krahasohen me katalogun/skedën teknike të pajisjeve dhe specifikimet teknike të DST për përputhshmërinë e tyre). Kataloget duhet të jenë të perkthyer në gjuhën shqipe.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve /skedës teknike të lëshuar/publikuar nga prodhuesi është një kërkesë e domosdoshme pasi i jep mundësinë AK - Organit Qëndror Blerës verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të hartuara nga Autoriteti Kontraktor përfitues për llogari të të cilit Organi Qëndror Blerës ka tagrin për të zhvilluar procedurën e prokurimit.

Për sa më sipër AK krijon siguri dhe garanci se mallrat me të cilët do të furnizohet janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DST. Ky katalog do të shërbejë gjithashtu edhe në procesin e marrjes në dorëzim të pajisjes objekt prokurimi nga Autoriteti Kontraktor përfitues për të kryer krahasueshmërinë e specifikimeve teknike gjatë marrjes në dorëzim të tij.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë oferten teknike për të gjithë artikujt e kërkuar, në formë tabele, ku të plotësohen: Emri i kompanisë prodhuese, Origjina e mallit, Emertimi i katalogut të artikullit/ produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 të LPP dhe nenin 40(8) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Kërkesa është vendosur duke marrë gjithashtu në konsideratë piken 1 të nenit 36 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik", në të cilën është e përcaktuar se:

1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurorët.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Gjithashtu ky kriter është në përputhje me piken 2 të nenit 40 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", ku përcaktohet se: 2. Për mallrat që do të prokurorët, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Në këtë kontekst është kërkuar dhe oferta teknike në formë deklarative, me anë të së cilës do të bëhet i mundur verifikimi me të saktë i artikujve të ofertuar, specifikimeve të tyre, origjina, konformiteti me dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga ofertuesi. Duke marrë shkas nga kompleksiteti i artikujve objekt prokurimi, gjykohet e nevojshme që gjatë fazës së vlerësimit komisioni i vlerësimit të ofertave të njihet me ofertën teknike, për të bërë të mundur një vlerësim sa më eficient dhe sa më të mirëorientuar.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatën e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

ISO 9001:2015 (ose e përditësuar) "Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë" (e vlefshme) ose ekuivalent;

ISO 14001:2015 (ose e përditësuar) "Mbi Sistemet e menaxhimit të mjedisit" (e vlefshme) ose ekuivalent;

Argumentimi: Këto kritere janë vendosur në përputhje me nenin 79 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, në të cilën gjejmë të përcaktuara se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjë mbështet në piken 1 të nenit 44 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatën e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e

Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe nëmënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur. ISO 9001 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

AK Vlerëson të nevojshëm certifikimin e subjekteve ofertues me ISO 14001 ose ekuivalent, me qëllim garantimin se OE gëzon konfirmimet e nevojshme nga organizmi i vlerësimit të konformitetit, se ka ndërmarrë masa proaktive me qëllim minimizimin e ndikimit negativ në mjedis, si dhe zbaton kuadrin rregullator përkatës në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike :*Përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike është grupi i punës i ngritur pranë Autoritetit Kontraktor përfitues Departamenti për Teknologjinë e Informacionit/Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për objektin që prokurohet, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Specifikimet teknike të pajisjeve objekt prokurimi janë si më poshtë vijon;

Bazuar në kërkesat në rritje të Policisë së Shtetit për mirëmbajtjen dhe “pjesët këmbimi të infrastrukturës së sistemit të transmetimit Datacom”, me qëllim riparimin e defekteve teknike dhe garantimin e funksionimit të pandërprerë të sistemit, si dhe duke marrë parasysh zhvillimet më të fundit teknologjike në këtë fushë, paraqitet nevoja për realizimin e blerjeve të pjesëve këmbimi për vitin 2025.

Sistemi Datacom është sistemi primar i transmetimit të informacionit të përpunuar për Policinë e Shtetit. Në të transmetohet informacioni i përpunuar nga të gjithë sistemet e TI-së të shërbimeve të ndryshme të Policisë, si sistemet TIMS, RIMS, SAS, INTERPOL, EUROPOL, AFIS, E-MAIL, ADAMS, E-GJOBA, CCTV, etj. Transmetimi i këtij informacion kërkon që sistemi të punojë 24 h /7 ditë.

Për nga rëndësia dhe këndvështrimi i mirëmbajtjes duhet pasur parasysh që Datacom është një sistem, kompleksiteti i të cilit përfshin 127 linqe dhe 51 kabinete stacionare të shtrira në të gjithë territorin e vendit.

Stacionet përsëritëse janë të vendosura në pika dominuese pjesa më e madhe e të cilave kanë një infrastrukturë rrugore dhe kushte klimaterike të vështira.

Pas përfundimit të fazës së implementimit të sistemit datacom *ka nisur faza e mirëmbajtjes*. Për të garantuar vijueshmërinë e shërbimit dhe funksionimin normal të sistemit, janë të nevojshme, “*pjesët këmbimi të infrastrukturës së sistemit të transmetimit Datacom*”. Gjatë fazës së mirëmbajtjes të realizohet riparimi apo zëvendësimi i komponentëve të sistemit me pajisje radio link sipas teknologjisë aktuale, si dhe pjesë këmbimi për kabinetet e tipit "outdoor" të instaluar në pikat repetitore.

Ky sistem përbën një infrastrukturë kritike për komunikimin dhe transmetimin e të dhënave në nivel institucional dhe ka shtrirje në të gjithë territorin e vendit, duke mbuluar një numër të konsiderueshëm strukturash policore, pikat e kalimit kufitar, stacione të komunikimit dhe nyje të tjera operacionale të rëndësishme.

Bazuar në gjendjen e magazinës të DTI-së për vitin 2025 ka mungesa në pjese këmbimi për sistemin e ri të implementuar në të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit me shtrirje gjeografike në territorin e Republikës së Shqipërisë.

1. Box modular indoor (i brendshëm), 256 QAM me licencat përkatëse.

Banda e Frekuencës: 6, 7, 8, 15,23 GHz
Hapësira e kanalit: 7, 14, 28 ,40 ,56 , 80, 112 MHz
Modulimi: QPSK deri 256 AM të licencuar, me mundësi në të ardhmen deri 4096QAM
Ndërfaqet: 10 GbE4 SFP+, GbE 4 porta Rj45
Funksionet e L2: Kapaciteti maksimal 122Gbps VLAN: Bazuar në portën 802. IQ, deri në 4094 VLAN për pajisje Kualiteti i shërbimit: Hyrje: Komponenti Policer Dalje: 4 / 8 SP+ DWRR në formën e hierarkisë WRED pse WTD për shmangien e mbingarkesës Mbrojtja: RSTP, MSTP, ERPS Agregimi: LAG, SSW, RTA deri ne 5 kanale , MTA
Sinkronizimi: SyncE, PTP T-TC / BC (G.8375.1), TDM (STM-I, E-I, ACR), MODEM
Furnizimi me energji : -40.5 deri në 57 VDC
Temperatura: -5 0 C deri në 50 C (pa kondensim)
Tensioni i hyrjes: -48 VDC (SELV), nominal
Gama e tensionit të hyrjes: -40.5 VDC deri -60 VDC
Konsumi i energjisë: <30W

2. Box modular outdoor (i jashtëm 8, 15, 23 Ghz me licencat përkatëse)

Të përgjithshme	
Bandat e frekuencave	8, 15, 23 GHz

Kapaciteti	Kapaciteti linkut : 8-366 Mbit/s Ethernet / IP Throughput : 8-462 Mbit/s TDM 4xE1 - 100xE1 - 2xSTM-1
Modulimi : Fiks/Adaptiv	PSK, 16, 32, 64, 128 dhe 256 AM
Madhësia e kanalit	7, 13.75/14, 27.5/28/29.65 40 dhe 55/56 MHz
Opsionet e konfigurimit	1+0 (i pa mbrojtur), 1+1 (i mbrojtur (HSB)), 1+1 Diversitet në frekuencë ose në hapësirë ose XPIC (SD, XPIC)
Konektorët	
Konektori i kabllit IF	Tipi N
Ndërfaqja e antenës	Montohet direkt në antenë
Sistemi	
Hapësira Tx-Rx MHz	
15 GHz	315, 322, 420, 490, 644, 728
Hapësira Duplex Tx-Rx MHz	
Karakteristikat e transmetimit	
Kontrolli manual i fuqisë Tx	0-25 dBm
Kontrolli automatik i fuqisë së TX	E konfigurueshme në varësi të shuarjes së sinjalit
Fuqia në dalje me "Transmit Mute"	>50 dB
Karakteristikat në marrje	
Qëndrueshmëria e frekuencës	+/- 5 ppm
Niveli maksimal i marrjes RX	BER=1x10-6/BER=1x10-3 -15 dBm/ 0 dBm
Niveli I Erroreve BER	10-13
Standardet	
Operimi	ETS 300-019 -class 4.1
Siguria	IEC / EN 60950
Performanca e RF	EN 302 217-2
Karakteristikat Mjedisore	
Temperatura e Operimit	E garantuar : -33 to +55o C E zgjeruar : -45 to +65oC
Lagështia	100%

3. Çiftues për frekuencat 8, 15, 23 Ghz, simetrik 3dB

Specifikimet	
Bandat e frekuencave	8, 15, 23 Ghz

Polarizimi	Vertikal dhe Horizontal
Humbjet e hyrjes (kryesore)	3.5dB
Humbjet e hyrjes (standby)	3.5dB
Isolation	20 dB
Return Loss	20.8 dB

4. Valepërçues fleksibel Flexiguide 1.2m për frekuencat 8, 15, 23 GHz

Specifikimet	
Bandat e frekuencave	8, 15,23 Ghz
Gjatësia	1.2m
Shuarja	0.4 -2.65 dB/m
Madhësia	WRI 12/WR51/WR51
Ndërfaqja	PDR84/UDR84, PBR 140/UBR140, PBR220/UBR220

5. Konektorë N-type/TNC

Specifikimet	
Ti i konektorit	N-type/TNC
Impedanca	50 Q
Humbje e zakonshme (Insertion Loss)	0.05 dB
Rezistenca e kontaktit (brendshëm)	$\leq 1.5 \text{ mQ}$
Rezistenca e izolacionit	$\geq 5000 \text{ MO}$

6. Kabell koax. i frekuencës së mesme

Specifikimet teknike	
Lloji i produktit	Kabull koaksial
Materiali i mbështjelljes	PE
Dimensionet	
Madhësia nominale	0.400 in
Mbi diametrin dielektrik	7.24 mm 0.285 in
Përçuesi i brendshëm OD	2.74 mm 0. 108 in
Përçuesi i jashtëm OD	8.08 mm 0.318 in
Specifikimet Elektrike	
Impedanca e Kabullit	50 ohm

Kapacitanca	78 pF/m 23.774 pF/ft
Rezistenca DC, Përcjellësi i brendshëm	4.69 ohms/km 1.43 ohms/kft
Rezistenca DC, Përcjellësi i jashtëm	5.61 ohms/km 1.71 ohms/kft
Testi i Tensionit DC	2500 V
Fuqia	16 kW
Shpejtësia	85 %
Specifikimet mjedisore	
Temperatura e instalimit	-40 °C to +85 °C (-40 °F to +185 °F)
Temperatura e funksionimit	-40 °C to +85 °C (-40 °F to +185 °F)
Temperatura e ruajtjes	-70 °C to +85 °C (-94 °F to +185 °F)

7. Radrizator për kabinetet "Indoor' Eltek Delta Group FLATPACK S

1 Controller + 2 Rectifiers 1000W HE

Specifikimet teknike	
Tensioni i hyrjes	100 - 250 VAC
Konfigurimi i rrjetit	230VAC, 1 fazor ose 2x1 fazor
Frekuenca e tensionit	45 deri në 66 Hz
Tensioni i daljes	-48 VDC
Rryma maksimale	40A
Fuqia e konfiguruar	2KW
Kontrollues i heqshëm aktiv Kontroll dhe monitorim i avancuar përmes portës ethernet Radrizator 48V/1000W	
Tensioni nominal	185 - 250 VAC
Hyrja nominale e rrymës maksimale , ngarkesa e plote	5.9 ARMS
Frekuenca e punës	45 – 66 Hz
Tensionet e rregullueshme	43,5 - 57,6 VDC
Fuqia maksimale	1000W
Rregullimi statik i tensionit	± 0,5 %

8. Radrizator për kabinetet "Indoor", 48/1000HE 1P, 85-300VAC; 1000 W

Specifikimet elektrike	
Tensioni nominal	185 - 250 VAC

Hyrja nominale e rrymës (maksimale) , ngarkesa e plotë	5.9 ARMS
Frekuenca e punës	45 - 66 Hz
Tensionet e rregullueshme	43,5 - 57,6 VDC
Fuqia maksimale	1000W
Rregullimi statik i tensionit	± 0,5 %

9. Radrizator per kabinetet "Outdoor", 48V, 2000W

Specifikimet elektrike	
Tensioni nominal	185 - 250 VAC
Frekuenca e punës	45 - 66 Hz
Tensionet e rregullueshme	45 - 66 Hz
Fuqia maksimale	2000W
Rregullimi statik i tensionit	± 0,5%

10. UPS 3 KVA 3kVA

Specifikimet elektrike	
Tipi	Montim në rack
Kit i montimit në Rack	i përfshirë
Fuqia	Minimumi 3 kVA
Faktori i fuqisë	≥ 0.9
Forma e valës	Sinusoidale
Tensioni nominal	208/220/230/240VAC
Frekuenca	50/60 Hz +/- 6Hz
Bypass	Automatik
HYRJE "INPUT"	
Tensioni nominal	220VAC
Frekuenca	50Hz
Priza hyrëse	IEC 320 C20 ose Standard Industrial
BATERI "BATTERY"	
Bateritë duhet të jenë	Hot Swappable
Bateritë e brendshme	Të përfshira
Mundësi për të shtuar module të jashtme baterish	Po

11. Kondicioner hybrid, për rack outdoor 220VAC + -48VDC

Specifikime	
Kapaciteti ftohës	2000W
Kapaciteti ngrohës	600W
Temperatura e operimit	-40 °C - +55 °C
Ftohja	Përdor ftohësin R134a, në përputhje të plotë me RoHS
Mbrojtja elektrike	Mbrojtje e integruar kundër tensionit të lartë
Monitorimi	Funksione të avancuara për mbikëqyrjen e sistemit
Si uria &	Dizajn kundër ndërhyrjes dhe i sigurt
Niveli i mbrojtjes IP	Dizajn efikas me nivel mbrojtjeje IP55
Aplikimi	Në ambiente të jashtme

Dhe pjesët e këmbimit për këtë kondicioner

- 12. Kontrolleri kryesor për kondicionerin hybrid.**
- 13. Ekran LCD për kondicionerin hybrid.**
- 14. Mbrojtës nga shkarkimet atmosferike për tension DC**
- 15. Mbrojtës nga shkarkimet atmosferike për tension AC**
- 16. Pllakete elektronike për kondicionerin hybrid**
- 17. Tastiere për konfigurim dhe lexim të alarmeve për kondicionerin hybrid.**
- 18. Kondensator për kompresorin e kondicionerit hybrid.**

Specifikimet	
Fuqia	35 µF ±5%
Frekuenca	50/60 Hz
Tensioni	450VAC DB C
Certifikimi	C65R RoHS

- 19. Ventilator 48 V për qarkullimin e ajrit të brendshëm në kondicionerin hybrid.**

Specifikimet	
Tensioni	48V (36-5) DC
Fuqia	95W/66W
R ma	2.2 A
Rrotullimi	2700 r/min

20. Kondensator Fan, ventilator 48V për qarkullimin e ajrit të jashtëm për nxjerrjen e nxehtësisë në kondicionerin hybrid.

Specifikimet	
Tensioni	48V (36-57) DC
Fuqia	95W/66W
Rryma	2.2 A
Rrotullimi	2700 r/min

Shënim: Për çdo certifikatë, standart, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës të përmendur më lart, pranohet edhe ekuivalenti i tyre.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, janë hartuar nga njësia e prokurimit konform specifikimeve teknike. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

Bashkëlidhur këtij procesverbali:

- *Dokumentat e tenderit*

NJËSIA E PROKURIMIT